

“Hej”, thotë burri dhe i ngre vetullat si të ishte i befashuar që të shihte. Me një dorë është i mbështetur në parvaz, kurse në tjetrën e mban cigaren e pandezur. Është i veshur me këmbë të bardhë, të hekurosur me përpikëri, dhe me pantallona komode stofi. Të vështron me sytë e zinj, të fshehur pas syzeve me kornizë të hollë argjendi. Ndërkaq shprehja e befasisë shpirtmirë, që në çastin tjetër, tretet nga fytyra e tij dhe ajo përsëri bie ftohtë dhe e pashprehje.

“*Hi there*”, thua dhe i buzëqesh butësisht. “Lirisht?”

“Natyrisht”, *Come in, please* - të kemi pritur”, përgjigjet burri, i cili shqitet nga hyrja dhe zhduket në dhomën e errësuar të ditës të mobiluar thjesht.

Mi? - e pyet veten, ca i shqetësuar, por nuk thua asgjë. E kapërdin pështymën, shpejt kthehesh-pas vetes sheh vetëm trungun e tharë në oborrin e braktisur, trungun e vdekur që s’të thotë asgjë fare - dhe futesh.

Çdo gjë është bukur e çuditshme - jo tamam ashtu siç do të duhej të ishte. *Mi*.

Brenda, megjithatë, s’është askush.

Çastet rrjedhin ngadalë dhe kumbueshëm. Pauza është e pakëndshme dhe zgjat së tepërmi.

Prej nga e gjithë kjo dritë në këtë dhomë të errësuar, e pyet veten derisa ulesh në kolltukun e pakushtueshëm, të mbuluar me perde të vjetër të shqyer, por ende nuk flet. Në vend të kësaj, me një interesim morbid, i analizon tapetet e zhubrosura, të stërvjetra, me mostër luleje, të cilat janë, në njërin prej qosheve, shumë të dëmtuara dhe të copëtuara nga lagështia që depërton nëpër mur. Burri rri në kolltukun pranë tëndit dhe hesht. Gjatë rrugës deri këtu je ngopur së ngrëni e së piri kafe, e tani vetëm gërgërimat e tretjes nga barku yt shakull përzihen me fëshfërimën e qetësisë në këtë shtëpi të braktisur, të ftohtë.

Ndoshta s’është dashur të haja, përsërit më vete qortueshëm, *me siguri s’është dashur të haja*.

Je nervoz, i frikësuar, pështyma të ngjitet në fyt, zemra të rrahë fort.

Ndoshta s’është dashur të vija, i përsërit më tej variacionet tuaja, *me siguri s’është dashur të vija*.

Burri rri qetë në kolltukun përballë tëndit dhe një kohë vetëm të vështron me kujdes të përqendruar. Mandej, hovshëm, me të dyja duart, u bie shalave i gatshëm të ngrihet.

“*Well, then*”, thotë më në fund, “*ta tregoj thertoren time...meat?*”

Xhejms Rajs (në gjithë planetin shumë më i njohur me TV - pseudonimin Oahu Xhim) për herë të parë është takuar me këtë burrë, plot dy javë më parë, para restorantit në qendër të qytetit, *just off Market Street*. Atëherë, ç'është e vërteta, ende nuk ia dinte emrin, por vetëm atë *nickun* e tij të pazakonshëm nga internet – *forumi www.yourdarkestdreams.com*, ku edhe janë njoftuar - *Predatori_1985*. Ndonëse me ditë të tëra e kishte përfytyruar si kasap italian, me fanellë të bartur e me krahoshe, me krahë, shpinë dhe stomak leshatak, me përparëse të ngjeshur dhe me satër të madhe në dorë, para restorantit, mu në kohën e caktuar, qëndronte dhe priste me durim – një burrë krejtësisht tjetër, me pamje të thjeshtë, shumë më i ri, më i shkurtër dhe më i hajthem se ai, me ten ngjyrë ulliri, me flokë të shkurtër dhe të krehur me saktësi në mes dhe me mustaqe të shkurtuara me rregull, veshur me kostum të keq të mbyllët.

Megjithëkëtë, pa mëdyshje, ai është.

Predatori_1985 nga internet – *forumi www.yourdarkestdreams.com*.

Xhimi – ende - nuk e njeh me asnjë emër tjetër.

(*Nicku i Xhimit* në *yourdarkestdreams.com* ka qenë *meat*. Thjesht *meat*).

Derisa i afrohet Xhimi s'e heq shikimin prej tij. E ka të qartë se *Predatori* nuk e sheh atë, dhe kjo i jep njëfarë përparësie, sado relative, përparësi që e gëzon. Ecën drejt tij dhe pret kur ky do ta regjistrojë me instinktin e tij të ftohtë, të pagabueshëm, por - kjo s'ndodh. Jo, ai vetëm qëndron atje, i veshur keq, duke shikuar skajet e këpucëve të tij, pa i shkuar fare mendja se dikush e përcjell, dhe i përvidhet anash. Do të mund t'i afrohej pa e vërejtur dhe ta neutralizonte vetëm ashtu.

Cap - *no problemo!*

E *Predatori* s'do të bëzante. Për asgjë ai s'është i vetëdijshëm. *Predator - my ass!* mendon Xhimi derisa i afrohet fare haptas, frontalisht, me një qeshje vesh më vesh, të njëmendtë, në fytyrën e madhe të mbuluar me mjekër të shkurtër *salt & pepper*. Atëherë (më në fund!) burri e vëren dhe e kthen shikimin drejt tij, por xhamat e syzeve të tij e reflektojnë dritën e fuqishme të rrugës dhe e fshehin shikimin e tij zhbirues. Kur e shqipton përshëndetjen e tij kurtoaze, zërin e ka të ulët dhe mezi depërton përmes zhurmës së rrugës.

Qeshet, kurse drejt Xhimit, në atë moment, vezullon treshja e artë, lart djathtas. Xhimi prek dorën e shtrirë: është e butë dhe e ndjeshme, më e imët se e tij. Sikur t'i mbyllte sytë, do të ishte i sigurt se përshëndetej me ndonjë grua.

Derisa përshëndeten - butësisht dhe me maturi dhe sipas të gjitha rregullave të pashkruara të sjelljes diskrete, joformale, e cila është bërë normë gjatë gjysmës së dytë të shekullit njëzet në pjesën më të madhe të planetit Tokë - me një vështrim të shkurtër Xhimi e mat nga kryet deri te këmbët: kostumin e tij teget prej sintetike dhe qafëzën e këmishës së lirë, të hedhur nga bartja e tepërt, edhe kravatën laroshe dhe këpucët e zeza të shqyera. “*Ok, let's go*”, thotë më në fund, me një psherëtimë mezi të dëgjueshme dhe me dorë tregon nga hyrja, tej mase i vetëdijshëm për rrobat e tij personale, të zgjedhura me kujdes: *fatigue chinos* dhe PAUL SMITH-in e gjelbër të mbyllët, *turtle-neck sweater*, BURBERRY'S *trench coat* ngjyrë bezhë dhe *matching scarf*, çorape të lehta bordo dhe *tasseled loafers* nga lëkura e butë ngjyrëgështenjë, të blera në Kovent Garden gjatë vizitës së tij të fundit në Londër.

“Kurrë s’ke qenë këtu?”, e pyet Xhimi duke e shikuar menynë, pasi që të dy ishin ulur pranë tryezës së rezervuar në bistrinë, tani për tani më të njohur filadelfase *Red Hen*. “*It’s kinda famous*”.

“I see”, thotë bashkëbiseduesi dhe mysafiri i tij, kurse Xhimi rrudh me krahë dhe përsëri përqendrohet tek menya, ndërsa *Predatori*, me gishtërinj të kujdesshëm dhe të ndjeshëm, ngjyrëkafetë bardhë, e merr kulaçin nga tabakaja e drunjtë, e thyen dhe me kujdes, copë pas cope, e fut në gojë dhe, pastaj e përtyp, e në fytyrë i vërehen shenjat e mundimit dhe të monotonisë.

“Pashije?”, pyet Xhimi dhe e largon menynë.

“Shumë e njelmët mik”, ia kthen Nihil Musa dhe rrudh me krahë sikur të kërkonte falje.

“*Fucking pretzels*”, zëshëm qeshet Xhimi. “I never really liked them!”

Por, pasi që bashkëbiseduesi i tij vetëm rrudh krahët papërcaktueshëm dhe me zor e gëlltit një copë bukur të madhe të kulaçit, Xhimi lëshohet në karrigen e rehatshme dhe hurb ujin e ftohtë nga gota e madhe. “Ca ndryshe të kam përfytyruar”, thotë pastaj mendueshëm dhe duke shikuar anash, mu sikur të mos i drejtohej askujt posaçërisht.

Burri ia pret me një buzëqeshje të ëmbël. “*Yes*”, ripohon me gjysmë zëri - do të mund të ishte ky konstatim njësoj sa edhe pyetje. Dhe hesht.

“*Yeah*”, ripohon Xhimi pasigurt.

Çast pauze.

“*Quhem Nihil Musa*”, thotë atëherë *predatori* Xhimi. Xhimi e ngre shikimin drejt tij. “*Nihil Musa Baksi*”, ripohon ngadalë, duke tundur kokën pas çdo rrokjeje, si dikush që tashmë është mësuar me atë që njerëzit të mos ia mbajnë mend emrin me të parën.

“*Ni - hil-Mu-sa Ba-ksi*”, rrokjezon Xhimi pas tij dhe tund kokën. *Predatori* buzëqesh - shtiret i kënaqur me interpretimin e Xhimit.

“*And what is your name, my friend?*”, thotë Nihil Baksi atëherë. “*You never told me your real name*”.

Xhimi e pi një gllënjë ujë, për të fituar kohë, pastaj me pecetën prej pëlhure, të kollarisur e të mbështjellë fort, i fshinë cepat e buzëve. “Emri im s’është me rëndësi”, e reciton atë që më parë e kishte përgatitur për këtë rast. “*I mean, I don’t have a real name any more*”.

Kjo, sipas të gjitha gjasave, fare nuk i pengonte Nihil Musës. “*I call you meat, then, like when we chat*”, thotë ai. “Meat is fine for me”. Reflektimi në xhamat e syzeve të tij është gjithnjë e më i fortë dhe Xhimi mezi arrin ta shikojë në fytyrë.

Ndërkohë, mu atëherë para tyre paraqitet pronari i bistroës. E njëj Xhimin dhe dëshiron t’ia japë dorën, t’i shprehë respekt. Edhe Xhimi e njëj atë, ndonëse këtë s’e tregon me asgjë. E ka parë atëkohë në programin e mëngjesit, *highlighted hair*, buzëqeshjen nga reklama e pastës për dhëmbë, tenin e kuqërremtë, fytyrën që s’e tregonte moshën, elegant, sado që, ndoshta/me siguri *fake* theksin e anglishtes dhe gjithë atë *lingo* të vetëdijshëm, të fryrë kulinaro-restorantor. Xhimit s’i pëlqejnë tureçkat e tilla, por ky cucërrohet aty para tij, dhe kjo nuk mund të mos i pëlqejë egos së tij. I rikujtohen disa nga emisionet e Xhimit, *Aventurat e Oahu Xhimit* - po ky është TV - shou i tij i preferuar nga fëmijëria.

“Pra, jeni bukur i ri”, komenton Xhimi me sarkazëm, kurse pronari qeshet me zë dhe shtirur, sikur të ishte edhe ky programi i mëngjesit në rrjetin kabllor, andaj duhet të jetë *upbeat* dhe plot optimizëm të palëkundshëm dheme disponim të mirë. Dhëmbët i ka të një bardhësie të padurueshme. Derisa bisedojnë, Xhimit befas i shkrep se plotësisht kishte gabuar që e kishte zgjedhur ta sillte Nihil Musën në *Red Hen*. Në vend se këtu, është dashur ta zgjidhte ndonjë vend ku s’do ta njihite askush, ku askush s’do të afrohej t’ia jepte dorën e të këmbente buzëqeshje dhe fjali boshe, në ndonjë qymez të lyrshëm, ta dërgonte diku në çizstek dhe fençfrazj, apo në hougiz. Pasi mendon ca më mirë, askund, pse patjetër është dashur të hanin, ky kishte qenë propozim i marrë, kurse Xhimi s’kishte pasur mënyrë për t’iu shmangur, në të kundërtën do të shkonin diku për të pirë, apo, e mira e së mirës, askund, te shtëpia, *your place or mine*, edhe ashtu rreziku nga zbulimi është i gjithnduershëm dhe i përhershëm. Sepse, a ekziston ndonjë vend në këtë qytet, në gjithë shtetin, dhe në gjithë kontinentin, por edhe në planet, në të cilin dikush, siç është Oahu Xhimi, do të mund të llogariste në anonimitet të sigurt?

Well, whatever, thotë Xhimi më vete dhe njëkohësisht përpiqet që të bisedojë sa më lirshëm me pronarin e bistroës. *What the fuck*, mendon, *I don’t give a shit*.

Kurse Nihil Musa përsëri zgrap kulaçin. Shikimi i përqendruar i tij skanon njërin pastaj tjetrin, dhe përsëri njërin pastaj tjetrin. Shihet se përpiqet t’i ndërlihdë gjërat.

Pronari i restorantit qeshet me lajka dhe me zemërbutësi pranon çdo gjë që thotë Xhimi. Pastaj tërhiqet, ecën mbrapa si lake profesionist, tamam shërbim. U propozon verë të shkëlqyeshme të zezë italiane, që madje s’është as në listën e verërave, aq është ekskluzive

dhe e dedikuar vetëm për mysafirë të veçantë, dhe qeshet edhe një herë zëshëm dhe, personalisht, e anulon porosinë e mëparshme, kurse kamerierët e gatshëm dhe të shpejtë, pa vonuar, vetëm për Oahu Xhimi dhe shoqëruesin e tij të pazakonshëm, e sjellin shishen direkt nga bodrumi. Kjo është *on the house*, ua përkujton pronari i restorantit për t'ua bërë tamam të qartë, dhe largohet. Një minutë më pas para tyre mbin edhe kamerieri, dhëmbëbardhë, i skuqur dhe i sjellshëm sa të dhimbsej, edhe xhufkat e shndritshme të flokëve ngjyrëmjalte në të verdhë i kishte të njëjta me ato të pronarit, kloni i tij, ndoshta edhe dashnori. Pasi merr porosinë me gjithë pompozitetin e mundshëm, edhe ai tërhiqet duke ecur praptas. *Këtu të gjithë janë të trentë*, mendon Xhimi, duke e shikuar. Pastaj Nihil Musa dhe ai shterojnë gotë pas gote, dhe, hej, kjo verë vërtet qenka e mrekullueshme. Xhimi lëpihej pas çdo gllënjke, e pinë nga një gotë dhe prapë i mbushin. Buzët e Nihil Musës janë të çara dhe ca lëng i zi ka mbetur ndërmjet vurratave të lëkurës së tharë dhe të pëlçitur. Lëpihet edhe ai, e Xhimi e vështron dhe dridhje të ftohta ia përshkojnë kurrizin.

“So”, thotë Nihil Musa me një buzëqeshje të vockël. “*Oahu Jim. Very famous*”.

“*Hell, yeah*”, thotë Xhimi dhe buzëqesh me sa zë që ka. *What the fuck*, mendon. E shterojnë shishen, ndaj e porositin tjetrën - dhe kjo është *on the house*. Pronari vërtet është i xhymert sonte - Xhimi tashmë është xurxull, e ndien këtë, gjuha i bluan, s'pushon së foluri dhe, atëherë, mu kur duhet, arrin ushqimi, aq i mirë sa mund të pritej vetëm nga vendi siç ishte *Red Hen*. Njerëzit vijnë nga larg vetëm për të ngrënë këtu. Para tyre radhiten ushqimet e zgjedhura. Nihil Musa kridhet fare në pjatën me mish të pjekur pulastreni me mëmëligë që shkrihej, me kërpudha dhe domate të mëlmyera me gjalpë të bardhë të shkrirë, ha si i babëzitur, sikur ta kishte këtë shujtën e fundit në jetë. Xhimi me kujdes e pret një filetë mahimahie, ngjyra e ndritshme e verdhë, e gjelbër, e artë e së cilës është mbuluar me mëlmesa barërash, pastaj me pirun merr ca pilaf nga orizi integral, të cilit i është hedhur salcë nga xhenxhefili dhe është zbukuruar me qepë të reja të grira imët. Dhe, herë pas here, i bërë tapë, e ngre shikimin nga buzët e Nihil Musës që përtypen e përtypen, i shikon lëvizjet e ekuilibruara, të njëllojta të nofullave të tij, dukshëm më të forta se i gjithë konstruksioni i trupit të tij të imët dhe të brishtë. Xurxull i kapsallit sytë nga ajo grykë gllabëruese, e ndien se si fundoset në shpellën e purpurt të thellë.

“Xhejms”, e dëgjon atëherë zërin e njohur të çjerrë se si e thërret dhe me vrull trandet, saqë piruni, me vringëllimë të çmueshme nga përplasja e argjendit dhe mermerit, fluturon në dysHEME: “Xhejms, Xhejms, Xhimi, Xhimi, *for Christ's sake*”!